



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE URBANE ELBASAN

Elbasan, më 25 / 04 /2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Blerje materiale ndertimi dhe inerte”.

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar-Marrëveshje kuader –mallra”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Materiale ndertimi dhe produkte të ngjashme; Produkte të lidhura me materiale ndertimi

VLERA E FONDIT LIMIT - 3,333,333 (tremilionë e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa t.v.sh.

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhtë:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës3;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojcës 8;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % e fondit limit të prokuruar.

Kriteri 2.1 është vendosur referuar nenit 43 pika 1,2,3 dhe nenit 55 pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri 2.2 është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP-së dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistimin e taksave vendore” I ndryshuar.

3. Kapaciteti teknik dhe profesional:

3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lejuara nga një ent public ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri 3.1 është vendosur referuar në nenin 40 pika 4 dhe nenin 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë **një kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimalisht 7 ton**, për transportin e mallit objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme :

-Aktin e pronësisë së mjetit përkatës

Ose

-Kontratën noteriale të marrjes me qera të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo me qera) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me ane të Formularit Permbledhes të Vetedeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili verteton disponimin e automjetit, dorezohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

*Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.***

3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që ka lidhje me objektin e kontratës, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim, si më poshtë:

-SSH/ EN - ISO 9001:2015 në fushën e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

Kriteri **4.3** është vendosur në përputhje me Nenin 40 pika 6 germa c të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar në nenin 79 të LPP.

Ky kriter është vendosur që AK të ketë siguri që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me certifikatën e menaxhimit të cilësisë gjë e cila krijon bindjen dhe siguri që AK që ky OE do të ofertojë produkte të certifikuara të një cilësie të mirë e në përputhje me standartet ndërkombëtare të cilësisë, në përputhje me standartet ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga DPA.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT

XHOANA KOÇI

KRISTI MUÇA

BLERINA KOTORRI